

## 5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT OPERACIONAL

*Qëllimi kryesor i Administrimit të Rrezikut Operacional është të mirëadministrojë pasiguritë që shoqërojnë veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, të informojë në çdo kohë Administratorët, duke ndihmuar në procesin vendimmarrës mbi rreziqet e mundshme operationale që pengojnë arritjen e objektivave, apo të kenë ndikime negative financiare dhe/ose reputacionale.*

Njësia e Administrimit të Rrezikut Operacional, si një nga linjat e dyta të kontroleve në Bankën e Shqipërisë, ka vijuar aktivitetin e saj në drejtim të forcimit dhe rritjes së rolit të saj. Nga analiza vjetore e raportimeve të njësive të Bankës ka rezultuar që, kontrollet e brendshme të vendosura nga njësitet, janë përgjithësisht efektive për minimizimin/shmangjen e dëmeve/rreziqeve nga incidentet e ndodhura. Shqyrtimi i mundësisë së lindjes së rreziqeve të reja të lidhura me zhvillimet globale ka qenë fokus i vazhdueshëm i vlerësimeve dhe analizës së ekspozimit të Bankës ndaj rrezikut operacional.

### A. Vlerësimi i nivelit të administrimit të rrezikut operacional nga ekspertët ndërkombëtarë

Metodologjia e përdorur nga IORWG

Rritja dhe forcimi i aktivitetit të Njesisë, pasqyrohet në vlerësimin e fundit të kryer nga ekspertët ndërkombëtarë të organizatës IORWG (International Organization Risk Working Group).

Banka e Shqipërisë, si anëtare e organizatës së lartpërmendur, ka marrë pjesë në vlerësimin periodik të kryer nga kjo organizatë e 102 banka qendrore si dhe autoritete mbikëqyrëse dhe monetare (siç janë BIS, ECB, FMN). Vlerësimi i fundit është si më poshtë:

Për vitin 2024, vlerësimi nga IORWG për Bankën e Shqipërisë rezultoi 82.7%. Ky vlerësim është në linjë me vetëvlerësimet e fundit pozitive ndaj Bankës së Shqipërisë dhe përkon me kategorinë "I Menaxhuar", ku klasifikohen shumica e bankave qendrore. Nga kategoria "I Avancuar" me 86% janë vetëm disa pikë përqindje larg, që është dhe objektivi afatmesëm për t'u arritur nga njësia.

AD-HOC	BAZIKE	I MENAXHUAR	I AVANCUAR	I MATURUAR
<61%	≥61%	≥69%	≥86%	≥94%

Vlerësimi bëhet periodikisht bazuar në matricën e vlerësimit të IORWG, duke u bazuar në 5 shtylla kryesore:



- a) nivelin e dizenjimit të proceseve dhe sistemeve të kontrollit që mbulojnë këto procese,
- b) mënyrën dhe strukturën e organizimit të funksionit të administrimit të rrezikut,
- c) nivelin e raportimit të saktë dhe në kohë,
- d) rezultatet pas menaxhimit të rrezikut dhe
- e) kulturën e rrezikut, e cila është një sfidë që kërkon ndërgjegjësimit dhe trajnim të vazhdueshëm nga njësitë e Bankës.

Vlerësimi i kryer nga IORWG u realizua për të gjitha bankat qendrore të anëtarësuara për vitin 2024, në vijim të vlerësimit periodik vjetor. Ai certifikon nivelin e maturitetit nga një organizatë e pavarur ndërkombëtare të Administrimit të Rrezikut Operacional në Bankën e Shqipërisë, ndërgjegjësimit dhe edukimit të njerëzve, gjë që ka ndikuar dhe do të ndikojë në mirëfunksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve dhe funksioneve bazë dhe mbështetëse në kuadër të menaxhimit të rrezikut.

### **B. Menaxhimi i Vijueshmërisë së Veprimtarisë (BCM<sup>41</sup>)**

Funksioni i “Menaxhimit të Vijueshmërisë së Veprimtarisë” ka për qëllim përmirësimin e aftësisë reaguese të Bankës për të siguruar vazhdimësinë e proceseve kritike dhe për t’u kthyer në veprimtarinë normale të aktivitetit të Bankës, sa më shpejt të jetë e mundur, në rast ndërprerjeje operationale të gjatë apo një krize/emergjence. Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar një kuadër të plotë rregullativ për Menaxhimin e Vijueshmërisë së Veprimtarisë.

Pjesë përbërëse e këtij kuadri rregullativ janë edhe planet individuale të vijueshmërisë për çdo departament, strategjitë që ndiqen, si dhe detyrat e përgjegjësitë për çdo pjesëmarrës. Për të siguruar efektivitetin e tyre kryhen teste periodike siç janë: simulimet dhe reagimet ndaj fatkeqësive natyrore, sulmeve kibernetike etj.

Në këtë kuadër, në bashkëpunim me departamentet e tjera u zhvillua testimi i skenarëve të sulmeve kibernetike DDoS dhe Ransomware. Ky testim kishte objektiv kryesor të vlerëonte dhe siguronte që Banka të jetë e përgatitur për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive një emergjence të krijuar si pasojë e sulmeve kibernetike. Testimi u realizua me sukses dhe ndihmoi në rritjen e ndërgjegjësimit të stafit për t’u përballur me këto ngjarje.

Parandalimi i rrezikut, planifikimi i vazhdimësisë së veprimtarisë dhe përmirësimi në menaxhimin e incidenteve janë fokusi kryesor, për të siguruar qëndrueshmërinë e institucionit.

### **C. Funksioni i Sinjalizuesit në Bankën e Shqipërisë**

Në ndihmë të procesit të Administrimit të Rrezikut Operacional ka ardhur

---

<sup>41</sup> BCM - Business Continuity Management.



edhe konsolidimi i funksionit të Sinjalizimit. Bazuar në ligjin nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, kjo strukturë ka për qëllim:

- a) të parandalojë dhe të godasë korrupsionin në Bankën e Shqipërisë;
- b) të nxisë sinjalizimet mbi veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit;
- c) të mbrojë individët që sinjalizojnë veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës.

Banka ka funksionuar me bazën rregullative të plotë, me të gjithë udhëzuesit e mjetet e nevojshme për t’iu mundësuar punonjësve sinjalizimin e rasteve të dyshimta.

Për vitin 2024 nuk është raportuar asnjë rast apo veprim i dyshuar sinjalizimi.

